



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Prishtinë, Janar 2009

DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM TË TË GJITHA INSTITUCIONEVE FINANCIARE TË
KOSOVËS

Të nderuar zotëri/zonja


Siç keni qenë të informuar edhe më herët BQK-ja do vazhdojë me metodën e komunikimit në formë të Letrave Këshilluese.

Letrat Këshilluese letra kenë për qëllim që t'ju ofrojnë udhëzime dhe qartësi për çështjet të cilat ndikojnë në sektorin financiar në Kosovë. Si shembuj, do të diskutojmë zhvillimet e reja në Industri, veçanërisht në këtë kohë të shqetësimeve financiare globale.

Ne shpresojmë që vazhdimi i serisë së Letrave Këshilluese do të siguroj udhëzime dhe do jetë në shërbim tuajin.

Bashkëngjitur me këtë keni numrin e gjashtë, Letra Këshilluese 2009-1, sa i përket Standardeve Minimale për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit.

Me respekt,


Nexhat Kryeziu
Zëvendës Governor


Shkendije Himaj
Zyrtare Kryesore e Mbikqyrjes Financiare



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Letër Këshilluese 2009-01

Janar 2009

**STANDARDET MINIMALE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË
LIKUIDITETIT**

**STANDARDET MINIMALE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË
LIKUIDITETIT**

QËLLIMI

Në vazhdimësinë e kryerjes së aktiviteteve të saj mbikëqyrëse, BQK ka vërejtur se menaxhimi i rrezikut të likuiditetit është një çështje sistematike që kërkon vëmendjen e organeve qeverisëse të bankës. Në përgjithësi, në Kosovë kreditë bankare po rriten shumë më shpejtë sesa baza depozituese. Po ashtu, pasi që sektori bankar po bëhet çdo ditë e më i sofistikuar për sa i përket produkteve financiare që ofrohen, BQK do të luaj rolin e saj mbikëqyrës në mënyrë proaktive duke nxjerrë udhëzime të përgjithshme për bankat mbi menaxhimin e likuiditetit të tyre.

Si e tillë, përmbajtja e kësaj letre duhet të konsiderohet si udhëzues. Është e shkruar në kontekstin e sektorit bankar që aktualisht ekziston në Kosovë dhe do të ndryshohet sipas evoluimeve të sektorit. I përfshinë ato aspekte apo principe thelbësore të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të cilat mbikëqyrja e BQK-së i konsideron si esenciale. I përfaqëson standardet, të cilat BQK do t'i përdorë në inspektimet në vend për të parë dhe vlerësuar se sa mirë bankat e menaxhojnë ekspozimin e rrezikut të likuiditetit. BQK pret që bankat, edhe në mënyrë të pavarur, të zhvillojnë apo rishikojnë politikën, procedurat dhe sistemet e tyre për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në mënyrë që në thelb të jetë konform me këto standarde.

MENAXHIMI I VAZHDUESHËM I LIKUIDITETIT

A. Zhvillimi i një Strukture për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit

I. Secila bankë duhet të ketë një strategji të miratuar për menaxhimin e përditshëm të rrezikut të likuiditetit, në formën e politikave të shkruara

Sikurse me menaxhimin e llojeve tjera të rrezikut, menaxhimi i shëndoshë i rrezikut të likuiditetit së pari përfshinë krijimin e një strategjie për bankën në mënyrë që të sigurohet një mbikëqyrje efikase e bordit dhe menaxhmentit të lartë, si dhe operimin sipas një procesi të shëndosh për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollimin e rrezikut të likuiditetit. Formaliteti dhe sofistikimi i procesit për menaxhim të likuiditetit duhet t'i përshtatet nivelit të përgjithshëm të rrezikut të cilit i ekspozohet banka dhe aktivitetet e sofistikuara bankare.

Bankat duhet t'i japin prioritet të lartë strategjisë së tyre të likuiditetit. Aktivitetit kryesor i bankave është ngritja dhe ruajtja e likuiditetit adekuat. Shumë aktivitete bankare varen drejtpërdrejt nga aftësia e vazhdueshme e bankës për të siguruar likuiditetin ndaj klientëve. Si biznese të fuqishme me huazime, bankat janë veçanërisht të cënueshme ndaj problemeve të likuiditetit, si nga natyra specifike e vetë institucionit edhe nga ndodhitë e jashtme që ndikojnë në tregje si tërësi. Praktikisht, çdo transaksion apo detyrim financiar ka implikime në likuiditetin e bankës. Për këtë arsye, bankat duhet të krijojnë një strategji për likuiditetin, politikat dhe metodën e menaxhimit. Strategjia e likuiditetit duhet të paraqes trajtimin e përgjithshëm që do të ketë banka ndaj likuiditetit, duke përfshirë aspekte të ndryshme kuantitative dhe objektiva kualitative (specifike).

Strategjia e likuiditetit duhet të adresoj qëllimin e bankës për ruajtjen e fuqisë financiare dhe aftësinë për të përballuar ngjarjet stresuese në treg.

Strategjia e likuiditetit të bankës duhet të artikuloj politikat mbi aspektet e caktuara të menaxhimit të likuiditetit, siç është përbërja dhe kuantiteti i aseteve likuide, paqëndrueshmëria dhe/ose stabiliteti i detyrimeve (në veçanti depozitat dhe burimet tjera), niveli i angazhimeve kreditore, siguria relative në përdorimin e instrumenteve të caktuara financiare, si dhe burimet nga fondet mbështetëse për nevojat e likuiditetit. Në një shtirje më të vogël në Kosovë, duhet gjithashtu të përfshihet një metodë për menaxhimin e likuiditetit në valuta të ndryshme. Po ashtu duhet të ekzistoj një strategji e miratuar për të përballuar çrregullimet e përkohshme dhe afatgjata të likuiditetit.

Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet të komunikohet përgjatë organizatës, sidomos duke pasur parasysh faktin që në shumë banka, menaxhimi i likuiditetit nuk është më vetëm përgjegjësi e thesarit. Rënia në sistemet operative po ashtu mund të ketë ndikim substancial në rrezikun e likuiditetit. Të gjitha njësitë punuese në kuadër të bankës që kryejnë aktivitete që kanë ndikim në likuiditet duhet të jenë në dijeni të plotë të strategjisë së likuiditetit dhe të operojnë sipas politikave, procedurave dhe limiteve të aprovuara.

Menaxhmenti i lartë dhe personeli i përshtatshëm duhet të kenë një njohuri të plotë rreth asaj se si rreziqet tjera, duke përfshirë rrezikun kreditor, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional ndikojnë në strategjinë e përgjithshme të likuiditetit të bankës. P.sh problemet kreditore me palët

specifike mund të ndikojnë në sasinë e parashikuar të fluksit hyrës të parave të gatshme dhe të kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve alternative nga ana e bankës.

II. Bordi i drejtorëve të bankës duhet të aprovoj strategjinë dhe politikat e rëndësishme të lidhura me menaxhimin e likuiditetit. Bordi po ashtu duhet të siguroj që menaxhmenti i lartë ndërmer hapat e duhur për monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të likuiditetit. Bordi duhet të informohet rregullisht mbi gjendjen e likuiditetit të bankës si dhe menjëherë po që se ndodhë ndonjë ndryshim material në pozitën e likuiditetit aktual apo të mundshëm të bankës.

Për shkak të rëndësisë kritike të menaxhimit të likuiditetit për qëndrueshmërinë e secilës bankë, bordi duhet të aprovoj strategjinë e bankës për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Bordi duhet të aprovoj politikat e rëndësishme që e drejtojnë dhe ndikojnë në rrezikun e likuiditetit të bankës. Bordi gjithashtu duhet të aprovoj politikat dhe procedurat që identifikojnë linjat e autoritetit dhe përgjegjësisë për menaxhimin e ekspozimeve të likuiditetit.

Bordi i drejtorëve duhet të siguroj që menaxhmenti i lartë ofron udhëzim të qartë mbi nivelin e rrezikut të pranueshëm të likuiditetit në mënyrë që të jetë në pajtim me strategjinë e bankës për likuiditetin. Bordi po ashtu duhet të siguroj që menaxhmenti i lartë posedon politikat dhe procedurat për një monitorim dhe kontrollim efikas të rrezikut të likuiditetit.

Bordi duhet të monitoroj performancën dhe profilin e rrezikut të likuiditetit të bankës dhe në mënyrë periodike të rishikoj informatat, të cilat janë të sakta dhe të detajuara, që të jenë në gjendje të kuptojnë dhe vlerësojnë rrezikun e likuiditetit me të cilin përballen portfoliot kyçe të bankës dhe banka si tërësi. Bankat që kanë koncentrim të theksuara fondesh apo që pësojnë ndryshime të theksuara në përbërjen e aksioneve, pritet që të kenë rishikime më të shpeshta nga ana e bordeve të tyre.

Bordi, gjithashtu duhet të rishikoj planet kontingjente, duke përfshirë të gjitha fondet për mbështetje (back-up) të bankës për trajtimin e çrregullimeve dhe të ketë mundësi që të financoj disa apo të gjitha aktivitetet e saj në kohën e duhur dhe me një kosto të arsyeshme.

Siç ka vërejtur BQK, disa banka kanë një Bord të Drejtorëve shumë më aktiv dhe më të angazhuar se sa të tjera. Në ekzaminimet e tyre do të rishikohet shtrirja e angazhimit proaktiv nga vet bordi si me lartë, si dhe në rastet kur një bordi është më pak i angazhuar.

III. Secila bankë duhet të ketë strukturën e duhur menaxheriale për të ekzekutuar me sukses strategjinë e likuiditetit. Kjo strukturë duhet të përfshijë involvimin e vazhdueshëm të anëtarëve të menaxhmentit të lartë. Menaxhmenti i lartë duhet të sigurohet që likuiditeti është i menaxhuar mirë dhe se ekzistojnë politikat dhe procedurat e përshtatshme për të kontrolluar dhe limituar rrezikun e likuiditetit. Bankat, rregullisht duhet të rishikojnë limitet kuantitative dhe objektivat sa i përket madhësisë së pozitave të tyre të likuiditetit përtej horizontit të caktuar kohor.

Sikur edhe me elementet tjera të menaxhimit të rrezikut, një bankë duhet të posedoj strukturën e menaxhimit të rrezikut, në mënyrë që të ekzekutoj si duhet strategjinë e likuiditetit të bankës, politikat dhe procedurat. Bankat duhet ta angazhojnë nivelin më të lartë të menaxhmentit të bankës për krijimin e politikës së likuiditetit dhe për rishikimin e vendimeve për likuiditetin. Përgjegjësia për menaxhimin e likuiditetit të përgjithshëm të bankës duhet të bie mbi një grup specifik në kuadër të bankës. Kjo mund të jetë në formën e Komitetit të Aseteve/Detyrimeve (ALCO) të përbërë nga menaxhmenti i lartë, siç përcaktohet me Rregulloren e UNMIK-ut

1999/21 neni 20.5, në kuadër të departamentit të thesarit apo të menaxhimit të rrezikut. Në të gjitha rastet duhet të ekzistojnë verifikimet dhe bilancet e duhura.

Duhet të krijohet plani për rishikime më të shpeshta rutinore të likuiditetit si dhe për rishikime jo edhe aq të shpeshta por më të thella. Këto rishikime krijojnë mundësinë për të riekzaminuar dhe përmirësuar politikat dhe praktikat e likuiditetit të bankës duke pasur parasysh përvojat e likuiditetit dhe zhvillimin e aktivitetit bankar.

Menaxhmenti i bankës duhet të marrë vendime në lidhje me strukturën për menaxhimin e likuiditetit. Ai mund të centralizoj tërësisht menaxhimin e likuiditetit, mund të decentralizoj atë duke caktuar përgjegjësitë e njësive sa i përket likuiditetit të tyre, duke iu nënshtruar limiteve të përcaktuara nga menaxhmenti i lartë, apo mund të bëhet edhe kombinimi i këtyre të dyjave. Në të gjitha rastet, struktura e menaxhmentit duhet të lejoj fleksibilitetin e duhur, duke u siguruar që strategjia e likuiditetit dhe politika e shkruar, e aprovuar nga bordi, mund të implementohen me sukses. Cilado strukturë që përdoret, është me rëndësi kritike që të ekzistoj ndërlidhje e ngushtë në mes të individëve që janë përgjegjës për likuiditetin dhe të atyre që monitorojnë kushtet e tregut, si dhe të individëve tjerë që kanë qasje në informata të rëndësishme, siç janë menaxherët e rrezikut kreditor. Kjo ka rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe analizimin e skenarëve të stresit (“çka nëse”) që mund të dëmtojnë seriozisht likuiditetin e bankës.

Menaxhmenti i bankës duhet të caktoj limitet numerike dhe objektivat për të siguruar një likuiditet adekuat, limite të cilat do të rishqyrtohen nga mbikëqyrësit e BQK-së, sidomos gjatë inspektimeve në vend (on-site). Në anën tjetër, BQK duke përdorur autoritetin e saj ligjor mund të caktoj individualisht limitet për një bankë. Limitet, p.sh mund të caktohen për:

- a. Raporti i kredive ndaj depozitave sa i përket praktikave dhe kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të bankës.
- b. Mospërputhjet kumulative të fluksit të parave të gatshme (p.sh. kërkesa për neto financimin kumulativ si përqindje e detyrimeve totale) përgjatë periudhave të caktuara – ditën e ardhshme, pesë ditët e ardhshme, muajin e ardhshëm. Këto mospërputhje duhet të kalkulohen sipas një pikëpamjeje konservative të tregtueshmërisë së mjeteve likuide, duke llogaritur edhe zbritjen për të mbuluar paqëndrueshmërinë dhe çfarëdo rënie të çmimit në raste të detyrimit për shitje me zbritje dhe duhet të përfshijë rrjedhjet e mundshme si rezultat i tërheqjeve të zotimeve, etj.
- c. Mjetet likuide si përqindje e detyrimeve afatshkurtra. Përsëri, duhet të ekzistoj një zbritje për të reflektuar paqëndrueshmërinë e çmimit. Mjetet që përfshihen në këtë kategori duhet të jenë vetëm ato mjete që janë tejet likuide – p.sh. vetëm ato të cilat konsiderohen se janë të gatshme për treg edhe në periudhat e stresit.

Bankat duhet të analizojnë ndikimin e mundshëm të skenarëve të ndryshëm të stresit në pozitat e likuiditetit të tyre dhe në pajtim me këtë të përcaktojnë limitet e tyre. Limitet duhet të përkohjen me madhësinë, kompleksitetin dhe gjendjen financiare të bankës. Menaxhmenti duhet të definoj procedurat specifike dhe aprovimet e duhura për përjashtimet nga politikat dhe limitet.

Menaxhmenti i lartë duhet të siguroj se janë krijuar kontrollet e brendshme adekuate për të mbrojtur integritetin e procesit të vendosur për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.

Menaxhmenti i lartë duhet të siguroj, zakonisht nëpërmes të një ALCO, se likuiditeti menaxhohet me një qasje për një afat më të gjatë kohor, shumë më gjatë se sa menaxhimi i

përditshëm. Një mënyrë ideale do të ishte parashikimi i detajuar i fluksit të parave për të paktën një muaj më pas, apo edhe më gjatë. Parashikimi i fluksit të parasë duhet të ketë parasysh të gjitha aspektet që do të kenë ndikim në fluksin hyrës dhe dalës të likuiditetit në bilancin e gjendjes dhe atë jashtë-bilancor (në veçanti zotimet kreditore). Parashikimi i fluksit të parasë, gjithashtu duhet të ketë parasysh burimet formale mbështetëse të likuiditetit që janë në dispozicion të bankës me një paralajmërim të shkurtër.

IV. Një bankë duhet të ketë sistem adekuat informativ për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e rrezikut të likuiditetit. Raportet duhet t'i sigurohen në baza kohore bordit të drejtorëve të bankës, menaxhmentit të lartë dhe personelit tjetër përkatës.

Një sistem i fortë informativ i menaxhimentit është esencial për marrjen e vendimeve të drejta në lidhje me likuiditetin. Një sistem i tillë duhet të jetë mjaft fleksibil në mënyrë që të përballë rastisjet e ndryshme të mundshme.

Sistemi informativ i menaxhimentit duhet të ketë aftësinë për të kalkuluar gjendjen e likuiditetit në të gjitha valutat e mëdha me të cilat ka të bëjë banka, në baza individuale dhe të agreguara. Në kontekstin e Kosovës, kjo në rend të parë ka të bëjë me likuiditetin në euro, por gjithashtu edhe aktivitetet në valutat tjera kërkojnë vëmendje. Të gjitha bankat duhet të posedojnë aftësinë për të kalkuluar gjendjen e likuiditetit të tyre, në baza ditore për një periudhë të shkurtë kohore (p.sh deri në pesë vjet) dhe në ndërkohë, edhe për periudha specifike kohore, më të gjata, në mënyrë që të mundësojnë një menaxhim efikas dhe një monitorim nga afër të kërkesave për neto financimin. Kjo konsiston me parashikimet e fluksit të parasë të përmendura më lartë.

Sistemi informativ i menaxhimentit duhet përdorur për të kontrolluar pajtueshmërinë me politikat, procedurat dhe limitet e vendosura të bankës. Raportimi i shkallëve të rrezikut duhet të bëhet në baza kohore dhe duhet krahasuar me ekspozimet aktuale të likuiditetit kundrejt secilit limit të përcaktuar. Sistemi informativ, gjithashtu duhet të mundësojë menaxhimentin që të vlerësojë nivelin e trendëve të ekspozimit të likuiditetit të agreguar të bankës. Supozimet duhet të paraqiten qartë, në mënyrë që menaxhmenti të jetë në gjendje të vlerësojë vlefshmërinë dhe qëndrueshmërinë e supozimeve kyçe dhe të kuptojë implikimet e skenarëve të ndryshëm të stresit.

B. Matja dhe Monitorimi i Kërkesave për Financimin Neto

I. Secila bankë duhet të themelojë procesin për matjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të kërkesave për financim neto.

Një proces efikas i matjes dhe monitorimit është thelbësor për menaxhimin adekuat të rrezikut të likuiditetit. Qysh në nivelin themelor, matja e likuiditetit përfshinë vlerësimin e fluksit hyrës të parasë së gatshme të bankës kundrejt fluksit dalës të saj, në mënyrë që të identifikohet mundësia për çfarëdo neto mungesë që përcillet tutje. Siç u përmend më herët, kjo përfshinë kërkesat për financim për zotimet jashtë-bilancore. Një numër teknikash mund të përdoret për matjen e rrezikut të likuiditetit, duke filluar nga kalkulimet e thjeshta deri tek teknikat e modeleve të sofistikuar. Pasi që të gjitha bankat janë të ndikuara nga ndryshimet në mjedisin ekonomik dhe kushtet e tregut, monitorimi i trendëve të ekonomisë dhe tregut ka rëndësi kyçe për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. BQK do të rishikojë këtë proces, gjithmonë nëpërmes të ekzaminimeve të saj, me qëllim të matjes dhe menaxhimit të vazhdueshëm të kërkesave të financimit neto, bazuar në nivelin e rrezikut të likuiditetit dhe me qëllim të sofistikimit të menaxhimit të likuiditetit sipas nevojave të bankës.

Një aspekt i rëndësishëm për menaxhimin e likuiditetit është edhe të supozohet mbi nevojat e ardhshme për financim. Përderisa disa flukse të caktuara hyrëse dhe dalje të parasë mund të kalkulojen apo parashikohen lehtë, bankat duhet të kenë supozime edhe për nevojat e likuiditetit në të ardhmen, si për periudha afatshkurta edhe atyre afatgjata kohore.

Faktor tjetër me rëndësi është edhe roli kritik i reputacionit të bankës në aftësinë e saj për t'iu qasur fondeve pa vështirësi dhe në kohë të arsyeshme. Për këtë arsye, stafi bankar që është përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit të përgjithshëm duhet të jenë në dijeni të secilës informatë (siç është raporti i auditorit të jashtëm, opinionit mbi pasqyrat financiare, klasifikimi nga kompanitë e vlerësimit) që mund të ketë ndikim në perceptimet publike dhe të tregut mbi qëndrueshmërinë e institucionit. Në sektorin e tanishëm bankar të Kosovës, mundësitë për rritjen e fondeve përmes tregut janë shumë të limituara. Prandaj, strategjia dhe politika për menaxhimin e likuiditetit të bankave në Kosovë duhet të reflektoj realitetin e tanishëm bankar si një burim të kufizuar për rritje të shpejtë të likuiditetit.

Afati kohor për menaxhimin aktiv të likuiditetit nganjëherë është shumë i shkurtër, duke përfshirë likuiditetin ditor dhe për të siguruar se kërkesat e BQK –së për rezervën e likuiditetit janë përmbushur. Në veçanti, ditët e para gjatë një problemi të likuiditetit janë vendimtare për të ruajtur stabilitetin. Një afat i përshtatshëm kohor do të varet nga natyra e biznesit të bankës. Bankat të cilat janë të mbështetura vetëm në fonde afatshkurta apo që janë me financim tejet të paqëndrueshëm duhet që në rend të parë të koncentrohen në menaxhimin e likuiditetit të tyre në afat shumë të shkurtër (të themi në afat prej pesë ditësh). Do të ishte ideale, sikur këto banka të jenë në gjendje të kalkulojnë gjendjen e likuiditetit të tyre në baza ditore gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, menaxhimi i likuiditetit të bankës duhet të ketë parasysh nivelin e aseteve likuide dhe në veçanti stabilitetin e financimit të tyre (të quajtur shpesh “depozitat themelore”) dhe me anë të këtyre mjeteve, duhet të menaxhohen kërkesat e neto financimit përgjatë një periudhe më të gjatë, ndoshta prej një deri në tre muaj paraprakisht.

Duke përdorur një qasje më afatgjatë, bankat duhet të grumbullojnë të dhënat dhe të monitorojnë gjendjen e likuiditetit të tyre në periudha më gjata kohore. Në mënyrë tipike, një bankë mund të gjej zbrazëti financiare substanciale në periudha më të gjata, ndaj duhet të tentoj të plotësoj këto zbrazëti, nëse është e mundur, duke ndikuar në maturitetin e transaksioneve në mënyrë që të tejkaloj zbrazëtinë, apo duke përdorur informatat e depozitave themelore apo mjete të tjera për të përcaktuar stabilitetin e bazës së financimit. Financimi mbështetës, siç do të diskutohet më vonë, duhet të jetë pjesë e këtij procesi monitorues.

II. Një bankë duhet të analizoj likuiditetin duke shfrytëzuar variacionet e skenarëve “çka nëse”.

Për të vlerësuar nëse një bankë është likuide sa duhet, varet në masë të madhe nga aktivitetet e fluksit të parasë në rrethana të ndryshme. Kështu që analizimi i likuiditetit kërkon sajimin e skenarëve të ndryshëm “çka nëse”. Sipas secilit skenar, banka duhet të përpiqet të llogaris secilën lëkundje qoftë negative apo pozitive të likuiditetit që mund të shfaqet. Këta skenarë duhet të kenë parasysh faktorët e brendshëm (specifik-bankar) dhe të jashtëm (të ndërlikur-me tregun). Kështu që, përderisa likuiditeti në mënyrë tipike do të menaxhohet në rrethana “normale”, banka duhet të jetë e përgatitur për të menaxhuar likuiditetin edhe në rrethana anormale.

Banka duhet të përcaktoj afatin për fluksin e parasë për secilin lloj të asetit dhe detyrimit, duke vlerësuar probabilitetin e aktivitetit të atyre flukseve të parasë sipas skenarit, “çka nëse”, në

përdorim. Këto vendime rreth afateve specifike dhe madhësisë së flukseve të parasë janë pjesë përbërëse për menaxhimin e drejtë të likuiditetit në ardhmen.

Prandaj, përderisa, BQK pret që bankat që të menaxhojnë likuiditetin e tyre mbi baza të fluksit të parasë për një periudhë të ardhshme (deri në disa muaj) me anë të supozimeve normale për fluksin hyrës dhe dalës, po ashtu pritet, sidomos nga bankat më të mëdha dhe më të sofistikuara që të kenë të gatshëm skenarët “çka nëse”.

III. Një bankë duhet të rishikoj herë pas herë supozimet e përdorura në menaxhimin e likuiditetit për të përcaktuar nëse janë ende të vlefshme.

Pasi që gjendja e ardhshme e likuiditetit të një banke do të ndikohet nga faktorët që nuk mund të parashikohen çdoherë me saktësi, supozimet duhet të rishqyrtohen më shpesh për të përcaktuar vlefshmërinë e mëtejme të tyre, sidomos kur dihen ndryshimet rapide në shumë tregje bankare. Numri total i supozimeve kryesore që mund të bëhen, sidoqoftë është tejet i limituar. Ky seksion përpiket të përfshij supozimet e likuiditetit brenda katër kategorive më të mëdha: (a) asetet, (b) detyrimet, (c) aktivitetet jashtë-bilancore dhe (d) të tjera.

(a) Asetet

Supozimet rreth stoqeve të mjeteve të ardhshme të bankës përfshijnë: potencialin e tyre të tregtueshmërisë (që është i limituar në situatën e tanishme të Kosovës sa i përket tregjeve) dhe përdorimi i kolateralit, i cili mund të rris fluksin hyrës të parave të gatshme, shtrirja deri në të cilën asetet do të krijohen dhe shiten (që prapë është e limituar në Kosovë) dhe shtrirja deri në të cilën asetet e maturuara do të ripërtërihen dhe asetet e reja do të sigurohen.

Përcaktimi i aseteve potenciale të bankës përfshinë tri pyetje:

- Çfarë është proporcioni i aseteve të maturuara të cilat banka është në gjendje dhe dëshiron t'i shtyj maturimin apo ripërtërij?
- Çfarë është niveli i pritur i kërkesave për hua të reja që do të *aprovohet*?
- Çfarë është niveli i pritur i tërheqjeve të zotimeve për huazim, që banka do të ketë nevojë t'i rezervoj?

Në vlerësimin e nevojave normale për fonde, disa banka përdorin modelet historike të shtyrjes së afatit të maturimit, tërheqjeve dhe kërkesat e reja për huadhënie; të tjerët kryejnë analizat statistikore duke marrë parasysh ndikimet sezonale dhe ndikimet e tjera për të cilat besohet se përcaktojnë kërkesat për hua (p.sh huat e klientëve). Në anën tjetër, banka mund të bëjë projektme vlerësuese, apo të vlerësoj klientët e mëdhenj një nga një, ndërsa për të tjerët të aplikoj raportet historike.

Tërheqjet dhe kërkesat e reja për hua paraqesin shterim potencial të fondeve të bankës. Kësaj mund t'i referohemi si detyrime kreditore jashtë-bilancore dhe kërkon matje dhe monitorim nga afër për një menaxhim të duhur të likuiditetit.

Në disa raste, banka mund të ketë një liri më të madhe sa i përket kontrollit të këtyre gjërave, varësisht nga gjendja aktuale. P.sh gjatë kushteve të një likuiditeti të pafavorshëm, banka mund të vendos të rrezikoj që të dëmtoj disa raporte biznesore duke refuzuar të aprovoj hua të reja të cilat në rrethana normale do t'i aprovonte, apo mund të refuzoj që të respektoj afatin e përbushjes së huadhënieve, përveç në ato raste kur ato janë të detyrueshme (zakonisht kur është bërë pagesa e tarifës për angazhime).

(b) Detyrimet

Me analizimin e detyrimeve të bilancit të gjendjes të burimeve të fondeve kërkohet që banka të kuptoj karakteristikat e siguruesve të fondeve të saj dhe instrumenteve financues dhe mbi të gjitha, stabilitetin e bazës së financimit të tyre. Për të vlerësuar fluksin e parasë që del nga detyrimet e bankës, banka së pari duhet të ekzaminoj trajtimin e detyrimeve të saj në suaza normale të punës.

Kjo nënkupton vendosjen e:

- Nivelit normal të shtyrjes së maturimit të depozitave dhe detyrimeve tjera;
- Maturitetit efektiv të depozitave me maturitet të pakontraktuar, siç janë depozitat rrjedhëse dhe shumë lloje të llogarive të kursimit – me fjalë të tjera të përcaktohet se cilët depozita janë themelore sipas natyrës, pavarësisht maturitetit të pakontraktuar apo datës nominale të maturitetit.
- Rritjes normale në llogaritë e reja të depozitave.

Sikurse në vlerësimin e shtyrjes së maturimit dhe kërkesave tjera për hua, banka mund të përdor disa teknika të mundshme për të krijuar maturitete efektive të detyrimeve të saj, siç është përdorimi i modeleve historike të sjelljes së depozitave. Për depozitat e paafatizuara, qofshin depozita të individëve apo bizneseve, shumë banka kryejnë analiza statistikore që marrin parasysh faktorët sezonal, ndjeshmërinë e shkallës së interesit dhe faktorët tjerët makroekonomik. Për disa depozitues të shitjeve me shumicë, banka mund të bëjë vlerësimin e secilit klient mbi probabilitetin e shtyrjes së maturitetit. Përsëri, si rezultat përfundimtar është që nëpërmes të analizave të përcaktohet baza e depozitave themelore, e cila në përgjithësi mund të merret si financim më stabil, për dallim nga “financimi i paqëndrueshëm” i cili do të konsiderohet si më pak stabil.

Gjatë ekzaminimit të fluksit të parasë që del nga detyrimet e bankës në rrethana anormale (probleme specifike të bankës apo të tregut në përgjithësi), banka duhet të ekzaminoj disa pyetje bazike:

- Cilat burime të financimit ka gjasa të mbesin në bankë në çfarëdo rrethane dhe a mund të rriten këto – sërisht depozitat themelore apo financimet kryesore?
- Cilat burime të financimit pritet të bien gradualisht nëse problemet shfaqen dhe në çfarë shkalle?
- A është vlera e depozitave mjet për të kontrolluar shkallën e rënies?
- Cilat detyrime të maturuara apo detyrime me maturitet të pakontraktuar pritet që të pësojnë rënie menjëherë pas shfaqes së shenjës së parë të problemit?
- A janë detyrimet me tërheqje të hershme opsione që mund të përdoren?
- A posedon banka mjete mbështetës të likuiditetit që mund të tërheq dhe në çfarë rrethanash?

Dy kategoritë e para paraqesin zhvillimet e fluksit të parasë që kanë predispozita për të reduktuar fluksin dalës të parasë të parashikuar drejtpërdrejt nga maturitetet e kontraktuara. Përveç detyrimeve të identifikuar më lartë, kapitali bankar dhe detyrimet e afatizuara që nuk maturaon në kuadër të periudhës së përfshirë në analiza, ofrojnë amortizim të likuiditetit. Detyrimet afatgjata janë një lloj me rëndësi të veçantë i amortizuesit të likuiditetit.

Detyrimet që përbëjnë kategorinë e parë mendohet të rrinë brenda bankës, qoftë edhe në parashikimin “e rastit më të keq”. Disa depozita themelore, zakonisht mbesin në bankë, për shkak se depozituesit e shitjes me pakicë dhe ata të bizneseve të vogla mund të mbështeten në sigurinë e sektorit publik për t’i ruajtur nga humbja, ose për shkak se çmimi i ndërrimit të bankave, sidomos për disa shërbime biznesi siç janë llogaritë e transaksioneve, mund të jenë pengesë për afate shumë të shkurta.

Kategoria e dytë, detyrimet që ka gjasa të rrinë në bankë gjatë periudhave të vështirësive të lehta dhe të bien relativisht ngadalë gjatë krizave, mund të përfshijnë ato detyrime sikur që janë depozitat themelore që ende nuk janë përfshirë në kategorinë e parë.

Përvoja e vetë bankës mbi detyrimet me afat të shtyrë si dhe përvojat e institucioneve tjera problematike duhet të ndihmoj në zhvillimin e orarit për këto flukse parash.

Kategoria e tretë përbëhet nga mbetja e detyrimeve të faturuara, duke përfshirë disa pa maturitete të kontraktuara. Këtu zakonisht hyjnë disa depozita të mëdha të shitjes me shumicë, duke përfshirë depozitat e mëdha të afatizuara sipas normave të tregut përfitues apo edhe mbi normat e tregut. Sipas këtij skenari, qasja duhet të jetë konservative dhe të supozohet se këto detyrime që kanë mbetur janë shlyer sipas maturitetit më të hershëm të mundshëm, sidomos në skenarët e krizave, për arsye se paratë e tilla mund të derdhen në vende më të sigurta, përfshirë edhe vendet jashtë Kosovës. Faktorët siç janë diversifikimi dhe ndërtimi i raporteve konsiderohen si tejet të rëndësishme në vlerësimin e rënies së detyrimeve dhe kapacitetit të bankës për të rikthyer fondet. Prandaj, kur ekzistojnë problemet e tregut, disa institucione të një cilësie të lartë me reputacion të mirë të tregut mund të vërejnë se janë duke pranuar fluks më të madh të depozitave nga shitja me shumicë, në kohën kur pjesëmarrësit tjerë të tregut përjetojnë rënie të fondeve hyrëse. Megjithatë, bankat duhet të jenë të matura dhe të mos mbështeten në këtë si burim i financimit, pasi që klientët e mëdhenj po ashtu mund të parapëlqejnë që të mbajnë para të gatshme, apo siç u cek më lartë, t’i transferojnë mjetet e tyre jashtë sistemit bankar vendor.

(c) Aktivitetet jashtë-bilancore

Banka, gjithashtu duhet të ekzaminoj potencialin për fluksin substancial të parasë nga aktivitetet jashtë-bilancore. Natyra e kushtëzuar e shumicës së instrumenteve jashtë-bilancore e shton ndërlíkueshmërinë e menaxhimit të fluksit të parasë jashtë-bilancore. Veçanërisht, gjatë situatave stresuese, zotimet jashtë-bilancore, sidomos zotimet kreditore, mund të shkaktojnë një shterim të theksuar të likuiditetit.

Detyrimet e kushtëzuara të rastit, siç janë letër-kreditë dhe garancitë financiare, paraqesin një shterim të theksuar të fondeve të bankës, por zakonisht nuk varen nga gjendja e bankës. Një bankë mund të jetë në gjendje të konstatoj fluksin “normal” dalës të parave në suaza të një situatave rutinore dhe pastaj të vlerësojë mundësinë për një rritje të këtyre flukseve gjatë periudhave të stresit, zakonisht në raste të jostabilitetit të tregut.

Sidoqoftë, krizat e përgjithshme të tregut mund të nxisin një rritje substancial në shumën e tërheqjeve të letër – kredive të zotimeve tjera kreditore jashtë-bilancore, për shkak të rritjes së mospërmbushjeve në treg.

C. Menaxhimi i qasjes në treg

I. Secila bankë duhet që në mënyrë periodike të rishikoj përpjekjet e veta për të krijuar dhe ruajtur marrëdhëniet me bartësit e detyrimit, të ruaj llojlojshmërinë e detyrimeve, si dhe të përpiqet të siguroj mundësi për të shitur asetet.

Një komponent kritik i menaxhimit të likuiditetit është vlerësimi i qasjes në treg dhe njohja e opsioneve të ndryshme të financimit. Më thjeshtë, një bankë ka nevojë që të kuptoj se sa do të jetë financimi që ata mund të marrin nga tregu vendor dhe burimet tjera, qoftë në rrethana normale apo në rrethana të pafavorshme. Siç është theksuar më parë, tregjet vendore të parave në Kosovë aktualisht nuk janë të zhvilluara mirë, prandaj qasja në fonde shpesh mund të jetë nga vendet jashtë Kosovës.

Menaxhmenti i lartë duhet të siguroj se qasja në treg menaxhohet në mënyrë aktive nga personeli përkatës në kuadër të bankës. Mund të ekzistojnë marrëdhëniet me palët tregtare, bankat korrespondente, klientët e korporatës dhe sistemet e pagesave. Ndërtimi i marrëdhënieve të fuqishme me siguruesit kyç të financimit mund të siguroj një vijë mbrojtëse në problemet e likuiditetit dhe të shërbej si pjesë përbërëse në menaxhimin e likuiditetit të bankës. Shpeshësia e kontakteve dhe përdorimi i shpesh të burimeve të financimit janë dy indikatorët e mundshëm të fuqisë së marrëdhënies financuese.

Koncentrimet në burimet e financimit rrisin rrezikun e likuiditetit. Si rrjedhojë, për të kontrolluar shumëllojshmërinë adekuate të detyrimeve, banka duhet të ekzaminoj nivelin e sigurisë në burimet e caktuara financiare, si në nivelin individual ashtu edhe sipas llojit të instrumentit, natyrës së siguruesit të fondeve dhe tregut gjeografik. Në Kosovë, shërbimet komunale janë kontribuesit kryesor financiar në sektorin bankar dhe mbështetja në këtë burim të vetëm të madh të financimit kërkon monitorim të afërt nga ana e bankave si dhe një planifikim të detyrimeve të rastit, siç do të diskutohet në seksionin tjetër.

Përveç kësaj, banka duhet të përpiqet të kuptoj dhe vlerësoj përdorimin e financimit ndërmjet firmave për zyrat e biznesit individual të saj. Funkzioni i thesarit apo ndonjë grup tjetër i caktuar në kuadër të bankës duhet të jetë përgjegjës për monitorimin e opsioneve të ndryshme të financimit dhe trendet aktuale në kuadër të opsioneve të tilla. Në të gjitha bankat, menaxhmenti i lartë duhet që në mënyrë të vazhdueshme të jetë i vetëdijshëm për përbërjen, karakteristikat dhe shumëllojshmërinë e burimeve të tyre të financimit.

D. Planifikimi kontingjent

I. Një bankë duhet të ketë planin kontingjent që do të adresonte strategjinë për trajtimin e krizave të likuiditetit dhe që përmban procedurat për të kompensuar mungesën e fluksit të parave të gatshme në rastet emergjente.

Aftësia e bankës për të përballuar qoftë çrregullimet e përkohshme edhe ato afatgjatë, në mënyrë që të financoj disa apo të gjitha aktivitetet e saj në kohë të duhur dhe me kosto të arsyeshme varet nga fakti nëse posedon një plan formal kontingjent. Nëse banka mbështetet çdo herë e më pak në depozitat themelore si burim stabil i financimit dhe mbështetet më shumë në burimet dytësore të financimit (shpesh të quajtura si financime të paqëndrueshme), nevoja për plan kontingjent bëhet edhe më kritike. Planet efektive kontingjente duhet të adresojnë dy pyetje kryesore:

- A ka menaxhmenti një strategji për përballimin e krizave?

- A ka menaxhmenti procedurat për t'iu qasur fondeve në rastet emergjente – me fjalë të tjera, a janë formalizuar burimet mbështetëse të financimit?

Menaxhmenti i lartë duhet që realisht të adresoj këto pyetje në mënyrë që të përcaktoj sesi do të gjendet banka në rrethana të pafavorshme dhe anormale. Për më tepër, menaxhmenti duhet të identifikoj dhe kuptoj llojet e ndodhive që mund të nxisin planet kontingjente.

(a) Strategjia

Plani kontingjent, në mënyrë që të përballoj problemet e likuiditetit duhet të përbëhet nga disa komponentë. Më të rëndësishmet janë ato që përfshijnë koordinimin menaxhrial. Plani kontingjent duhet të detajizoj procedurat për të siguruar se rrjedha e informatave është e duhur dhe e pandërprerë dhe se menaxhmentit të lartë i janë siguruar informatat precize që nevojiten për marrjen e vendimeve të shpejta. Duhet të krijohet një divizion i përgjegjës në mënyrë që personeli të informohet mbi atë se çfarë pritet nga ata gjatë gjendjes problematike.

Një element tjetër madhor i planit duhet të jetë strategjia për marrjen e vendimeve të caktuara, nëse është e mundur, për të ndryshuar veprimet e aseteve dhe detyrimeve. Përderisa mund të bëhen supozime sesi një aset apo detyrim mund të silltet në një situatë të caktuar (siç u përmendën më herët), banka mund të jetë në gjendje të ndryshoj këto karakteristika. P.sh, banka mund të konkludoj se ajo do të ketë deficit të likuiditetit në krizat e bazuara në supozimet e saj sa i përket shumës së fluksit të ardhshëm hyrës nga asetet që shiten dhe fluksit dalës nga tërheqja e depozitave.

Komponentët tjerë të planit kontingjent përfshijnë ruajtjen e marrëdhënies në mes të klientëve dhe bartësve të detyrimeve, huamarrësve në anën e aseteve të bilancit të gjendjes dhe palës së kundërt jashtë-bilancore. Me intensifikimin e problemeve, bankat duhet të vendosin cilat asete mund të sigurojnë likuiditetin e nevojshëm pa humbje apo me humbje minimale. Në mënyrë tipike, bankat rishikojnë aspektin e aseteve që janë shumë pak të dëmshme për marrëdhëniet biznesore dhe perceptimet e publikut për sigurinë e bankës. Në të njëjtën kohë, marrëdhënia me bartësit e detyrimeve bëhet edhe më e rëndësishme në situata të vështira. Nëse strategjia e bankës kërkon që menaxherët e detyrimeve të mirëmbajnë lidhje të vazhdueshme dhe të fuqishme me palët e kundërta dhe bartësit e mëdhenj të detyrimeve (depozitorët e mëdhenj dhe burimet tjera të mëdha të financimit) gjatë periudhave të qetësisë relative, banka mund të jetë e pozicionuar më mirë tek burimet e sigurtat të fondeve në kohën e rrethanave anormale.

(b) Likuiditeti mbështetës

Plani kontingjent, gjithashtu duhet të përfshij procedurat për të plotësuar mungesën e fluksit të parasë së gatshme në situatat e vështira. Bankat duhet të kenë në dispozicion disa burime të fondeve të tilla, duke përfshirë kreditë e pashfrytëzuara. Këto duhet të jenë burime mbështetëse financuese, për të cilat tarifat zakonisht kërkohen. Varësisht nga përshkallëzimi i problemeve të likuiditetit, banka duhet të zgjedh - ose të detyrohet - të shfrytëzoj një ose më shumë nga këto burime. Plani duhet të qartësoj sa më mirë që është e mundur, shumën e fondeve mbështetëse që janë në dispozicion të bankës dhe sipas cilëve skenarë banka mund t'i shfrytëzoj ato fonde. Bankat duhet të jenë të kujdesshme që të mos mbështetën për së tepërmi në linjat mbështetëse dhe duhet të kuptojnë situatat e ndryshme, siç janë periudhat e njoftimit, që mund të ndikojnë në aftësinë e bankës për t'iu qasur këtyre linjave sa më shpejt. Në fakt, bankat duhet të kenë planet kontingjente për periudhat kur linjat e tyre mbështetëse nuk janë të disponueshme.

Siç u tha më herët, bankat duhet të kenë parasysh se në çfarë rrethanash dhe për çfarë qëllimesh ato do të krijojnë linjat e dedikuara për financim, për të cilat paguajnë tarifa, të cilat do t'i kenë në dispozicion në rrethana anormale në rast se mjetet lehtësuese të paangazhuara dështojnë.

E. Kontrollat e brendshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit

I. Secila bankë duhet të ketë një sistem adekuat të kontrollit të brendshëm mbi procesin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Komponenti fundamental i sistemit të kontrollit të brendshëm përfshinë rishikimet e rregullta dhe të pavarura si dhe vlerësimet mbi efikasitetin e sistemit dhe sipas nevojës, të sigurohet që janë bërë rishqyrtime dhe përmirësimet përkatëse të kontrolleve të brendshme. Rezultatet e rishikimeve të tilla duhet të jenë në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse.

Bankat duhet të kenë kontrolla të brendshme adekuate për të siguruar integritetin e procesit për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Kontrollat e brendshme të rrezikut të likuiditetit duhet të jenë pjesë përbërëse e sistemit gjithëpërfshirës të bankës për kontroll të brendshëm. Ata duhet të promovojnë operacione efikase, raportim të besueshëm financiar dhe rregullator, si dhe pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe politikat institucionale përkatëse. Sistemi efektiv i kontrollit të brendshëm të rrezikut të likuiditetit përmban:

- Kontroll të fuqishëm të mjedisit;
- Një proces adekuat për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të likuiditetit;
- Krijimin e aktiviteteve kontrolluese siç janë politikat dhe procedurat;
- Sistem adekuat informativ; dhe
- Rishikim të vazhdueshëm të zbatimit të politikave dhe procedurave të themeluara.

Sa i përket politikave dhe procedurave të kontrollit, duhet t'i kushtohet kujdes proceseve përkatëse të aprovimit, limiteve, rishikimit dhe mekanizmave tjerë që janë të dizajnuar për të ofruar garanci se janë arritur objektivat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të institucionit.

Shumë attribute të procesit për menaxhim të shëndoshë të rrezikut, duke përfshirë identifikimin e rrezikut, matjen, monitorimin dhe funksionet e kontrollit, janë aspekte kyçe të një sistemi efikas të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe ato aspekte që nuk janë pjesë e drejtpërdrejt e procesit për menaxhimin e rrezikut.

Për më tepër, një element i rëndësishëm i procesit për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është vlerësimi dhe rishikimi i rregullt. Kjo përfshinë sigurinë se personeli është duke i ndjekur politikat dhe procedurat e themeluara si dhe sigurinë që procedurat që janë themeluar aktualisht përmbushin objektivat e synuara. Rishikimet dhe vlerësimet e tilla duhet të adresojnë gjithashtu çfarëdo ndryshimi të rëndësishëm që mund të ndikoj në efikasitetin e kontrolleve. Menaxhmenti duhet të siguroj se të gjitha rishikimet dhe vlerësimet kryhen me rregull nga individët të cilët janë të pavarur nga funksioni të cilin e rishikojnë.

Me autorizimin e rishikimeve dhe përmirësimeve të kontrolleve të brendshme, duhet të ekzistoj një mekanizëm për të siguruar që implementimi i tyre është bërë në kohën e duhur.

Edhe pse procedurat për krijimin e limiteve dhe operimin e tyre mund të ndryshojnë nga banka në bankë, rishikimet periodike duhet të përcaktojnë nëse organizata është në pajtim me politikat dhe procedurat mbi rrezikun e likuiditetit. Pozitat të cilat tejkalojnë limitet e vendosura duhet të kenë vëmendjen e duhur të menaxhmentit përkatës dhe duhet të zgjidhen në pajtim me procedurat e përshkruara në politikat e aprovuara. Rishikimet periodike të procesit për

menaxhimin e likuiditetit duhet të adresojnë çdo ndryshim domethënës në natyrën e instrumenteve të përfituara, limitet dhe kontrollet e brendshme që janë shfaqur pas rishikimit të fundit.

Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të jetë komponent kyç në sigurimin e mirëmbajtjes së një kontrolli të brendshëm adekuat. Funksioni i auditimit të brendshëm duhet të rishikohet periodikisht në mënyrë që të identifikohet çfarëdo dobësie apo problemi. Në anën tjetër, këto konstatime duhet të adresohen nga menaxhmenti në kohë dhe mënyrë të duhur.

F. Mjetet lehtësuese të Bankës Qendrore

Aktualisht, BQK nuk ka themeluar ende mjetet lehtësuese likuide që janë tipike për bankat tjera qendrore. Po bëhen përpjekje për studimin, zhvillimin dhe implementimin e mjeteve përkatëse për sistemin; megjithatë, kur të krijohen këto mjete, ato nuk duhet të bëhen pjesë e planit të likuiditetit të bankave komerciale. Bankat nuk duhet të mbështeten në bankën qendrore gjatë planifikimit të likuiditetit të tyre.